



## **Shënime mbi plotësimin e FORMULARIT të KËRKESËS PËR PRONËSI (DËSHMI E INTERESIT) NË PROCESIN E RIORGANIZIMIT**

### **1. HYRJE**

Shënimet në vijim janë ofruar për të asistuar kërkuar për plotësimin e Formularit të Kërkesës për Riorganizim e jo-pronësisë (R25a Dëshmi e kërkesës). Nëse keni dyshim për çfarëdo aspekti të kërkesës suaj, fuqimisht këshilloheni të kërkonit këshillë dhe asistencë të pavarur ligjore. Asistenca e tillë nuk mund të ofrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Ju lutem vëreni posaçërisht që formulari i kërkesës duhet të nënshkruhet. Fakset dhe kopjet do të pranohen mirëpo Administratori mban të drejtën të kërkojë origjinalin në çdo kohë.

Keni kujdes të mos përdorni këtë formular për të kërkuar përfshirje në listat e punëtorëve për pjesëmarrje në 20% të ardhurave nga privatizimi ose likuidimi i Ndërmarrjes Shoqërore. Nëse parashtroni kërkesë të tillë përmes kësaj forme nuk do të shqyrtohet

Formulari i kërkesës përdor referencat e njëjta siç janë përdorur në nenin 34 të ligji mbi riorganizimin dhe ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre dhe është i përcaktuar sipas dispozitës së nenit 17.4 të ligjit të njëjtë.

#### **1.1 EMRI I NDËRMARRJES SHOQËRORE**

Është esenciale të shënohet emri i Ndërmarrjes shoqërore pasi që vetëm në këtë mënyrë kjo mund të identifikohet dhe kërkesa e juaj të bëhet e mundshme pas shqyrtimit nga Administratori.

#### **1.2 EMRI DHE ADRESA E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS**

PARASHTRUESI I KËRKESËS është personi fizik dhe ligjor i cili pretendon kundër Ndërmarrjes në Pronësi Shoqërore.

Nëse jeni person fizik ju lutem në këtë kuti shkruani emrin tuaj të plotë, adresën postare dhe numrat kontaktues të telefonit, fiks dhe mobil nëse është e mundur.

Nëse jeni person ligjor ju lutem shkruani emrin e regjistruar (dhe çfarëdo emri alternativ) regjistruar në adresën postare, numër telefoni dhe emër të personit kontaktues.

#### **2.1 LLOJET DHE SHUMAT E KËRKESËS**

Përzgjedh llojet që korrespondojnë më së afërmi me kërkesat që janë bërë dhe shkruaj shumën e përgjithshme të pretenduar për secilin lloj (p.sh. disa fatura për mallra) bashkangjit një listë të ndarë që identifikon artikujt individual, vlerat e tyre dhe totali siç është shkruar në formular. Nëse nuk është e mundur në të gjitha rastet një shifër e saktë, atëherë një shifër e vlerësuar dhe përshkruan atë si vlerësim.

Shkruaj ndaras shumat nëse zbatohet në kërkesën tuaj. Ofro detajet se si është llogaritur norma e interesit dhe siguro dëshmi për bazën ligjore të kësaj llogaritje.

Nëse shuma është në euro, shkruaj se në cilën valutë është parashtruar kërkesa. Nëse kërkesa është parashtruar në EURO bazuar në transformimin e valutës së kërkesës tjetër, siguro detajet e këmbimit të normës së valutës së përdorur, data, burimet dhe detajet e llogaritjes. Nëse shuma e pretenduar është në EURO bazuar në vlerën e faturës ose dokumenteve tjera mbështetëse, të lutem plotësoje shumën në EURO.

E dyta ndërlidhet me interesin e pronësisë.

### **3. PRONARËT E ASETIVE**

Kërkesat e pretenduara për interes të pronësisë në asete të caktuara ndërlidhet me situatën në të cilën aseti specifik, që i nënshtrohet kërkesës, është në posedim ose kontroll të ndërmarrjes dhe parashtruesi i kërkesës kërkon që ky aset ti kthehet. Zakonisht këto janë asete që janë lëshuar me qira, janë dhënë ose përdorur në operime të përbashkëta ndërmjet pronarit të pretenduar dhe ndërmarrjes. Në këtë rast parashtruesi i kërkesës duhet të përshkruaj llojin e asetit, të siguroj dëshmi të pronësisë dhe vlerë të asetit nëse është e mundshme të vlerësoj atë.

Të lutem ofro (një fletë ndaras) të gjitha detajet relevant të asetit për cilën pronësi është parashtruar kërkesa (numrat serik, lokacioni fizik etj) pra që ata të identifikohen fizikisht. Në është e mundshme, poashtu bëj një vlerësim të vlerës individuale të secilit aset.

Duhet të ofroni dëshmi dokumentuese për të provuar që aseti është në pronësinë tuaj dhe të sqaroni pse asete janë me Ndërmarrjen.

### **4. PRONËSIA E NDËRMARRJES**

Interesi i pronësisë në Ndërmarrje ndërlidhet me kërkesën e pretenduar që parashtruesi i kërkesës ka në pronësi pjesë të të gjitha aksioneve të kapitalit të Ndërmarrjes. Parashtruesi i kërkesës duhet të vendos [X] në kutinë e duhur në formular të cilin ai/ajo beson që e sqaron më së miri cila është lidhja me ndërmarrjen, themeluesit, partnerët, aksionarët, pjesëmarrës ose pronar. Ankuesi duhet të ofroj dëshmi e evidencës për pronësinë e tij/saj, dhe në veçanti:

- (i) Dokumentet që sqarojnë bazën ligjore të kërkesës së pretenduar të pronësisë;
- (ii) Kopjet e aksioneve/certifikatave të regjistrimit;
- (iii) Kontrata për shitblerjen e aksioneve. Dëshmi e pagesës së aksioneve.
- (iv) Detajet e vlerës së aksioneve në rast të shndërrimit të borxhit të ekuitetit (përfshirë kopjet e çfarëdo marrëveshje të tillë); dhe
- (v) Dëshmi që aksionet janë lëshuar në mënyrë valide dhe që çfarëdo transformimi nga ndërmarrja në pronësi shoqërore në shoqëri aksionare është bërë në mënyrë valide.
- (vi) Vlera monetare e kërkesës.
- (vii) Dokumentet tjera që mbështesin kërkesën e pretenduar të pronësisë në ndërmarrje.

### **5. VEPRIMET/PROCEDURAT E MËPARSHME TË NDËRMARRA PËR REALIZIMIN E KËRKESËS/ANKESËS**

Në kuti të posaçme me titullin e njëjtë si më lartë, parashtruesi i kërkesës duhet të përshkruar nëse ai/ajo ka ndërmarr ndonjë veprim ndaj Ndërmarrjes ose Agjencisë, ose ai ka filluar ndonjë procedurë ligjore për realizimin e kërkesës së tillë të pretenduar. Veprimi mund të jetë: parashtrimi i mëparshëm i kërkesës në Ndërmarrje, ish Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ose

Agjencia Kosovare e Privatizimit ose Gjykata. Është e nevojshme të bashkëngjiten dokumentet për të identifikuar veprimet e ndërmarra ose procedurën e filluar.

#### **6. DOKUMENTET MBËSHTETËSE**

Këtu shkruaj përmbledhjen e dokumenteve që do të bashkëngjiten formularit në mbështetje të aplikacionit tuaj. Nëse ka hapësirë të mjaftueshme për të vendosur dokumentet e bashkëngjitura, të lutem përdore një fletë tjetër.

**MOS DËRGO DOKUMENTET ORIGJINALE** – bashkëngjiti vetëm kopjet që i keni vërtetuar si kopje të vërteta të dokumenteve origjinale me të cilën bazohet kërkesa e juaj.

#### **6. DEKLARAT E TË VËRTETËS**

Ju lutem siguroni që kjo deklaratë është plotësuar. Shkruaj emrin e parashtruesit të kërkesës (personi fizik/ligjor). Nëse kërkesa është bërë nga personi u autorizuar në emër të parashtruesit të kërkesës, personi i autorizuar duhet të nënshkruaj formularin poashtu. Autorizimi i verifikuar ligjërisht duhet të bashkëngjitet formularit. Përfundimisht, nënshkrimet duhet të jenë origjinale të shkruara me dorë.

**Vërejtje: Çdo person i cili me dashje parashtron kërkesë që është fals dhe mashtrues mund të përndjeket penalisht**